



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur/panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 87-të, të mbajtur më 01.06.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-1193/1 të datës 20.02.2023 në lidhje me dhënien e lejes për ndërtim, HIDHET POSHT.

KKPK-ja konstatoi se, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë, sepse nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të personave zyrtarë në ushtrimin e kompetencat publike dhe detyrat zyrtare, dhe nuk ka mundësi për të dhënë informacion shtesë për pretendimet në denoncim për shkak të anonimitetit të denoncimit.

Lënda me numër 12-1193/1 të datës 20.02.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më datë 20.02.2023 është dorëzuar denoncim nga një parashtrues i panjohur lidhur me lejen e ndërtimit të lëshuar dhe është konstatuar rasti me numër 12-1193/1 datë 20.02.2023.

Në denoncim, parashtruesi thekson se Ministria e Transportit dhe Lidhjeve i ka lëshuar një leje ndërtimi investitorit ----- si rezultat i abuzimeve të mundshme dhe të kryera më parë. Vepër penale të kryer me elemente korrupsioni.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja arrin në përfundimin se në rastin nuk ka të dhëna të mjaftueshme për t'i konkretizuar pretendimet e denoncuar, nuk është theksuar se për çfarë lloj investimi bëhet fjalë apo vendndodhja e ndërtesës, dhe KSHPK-ja nuk disponon mundësi për të dhënë informata shtesë për pretendimet në denoncim për shkak të anonimitetit të parashtruesit, pas së cilës ai ka vlerësuar se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Nga sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

përgatiti: Mr. K.Z

Miratoi: N.B, anëtar i K ShPK-së

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија

Адреса: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut

email: contact@dksk.org.mk

тел/tel: +389 2 3248 930

<https://www.dksk.mk>

KORRUPSIONIT

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР ПЁР
PARANDALIMIN E

Нёнкрыетар,
Катика Николовска